



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT**

N J O F T I M

**PËR ZHVILLIMIN E TESTIMIT TË INFORMATIZUAR TË KANDIDATËVE PËR
T’U PUNËSUAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR PORTALI I MËSUESIT 2026**

Në zbatim të Udhëzimit nr. 9, datë 03.05.2024 “Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, si dhe të shkresës së Ministrisë së Arsimit nr. 3944 prot., datë 20.05.2026 “Për realizimin e procedurave të konkurrimit të mësuesve në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2026”, ju informojmë se testimi i informatizuar do të zhvillohet në godinën e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë, ish-ATSH), gjatë periudhës **Korrik – Gusht 2026**.

Ditën e zhvillimit të testimit të informatizuar, kandidatët duhet të kenë parasysh rregullat e mëposhtme:

- a) Të jenë të pajisur me dokument identiteti (kartë identiteti ose pasaportë biometrike);
- b) të paraqiten së paku 30 minuta përpara fillimit të testimit;
- c) të mos mbajnë dhe të mos përdorin celularë dhe mjete të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të testimit, pasi kjo vlerësohet si kriter përjashtimi;
- ç) të mos pijnë duhan dhe të mos konsumojnë ushqime në mjediset e testimit;
- d) të mos komunikojnë me njëri-tjetrin gjatë zhvillimit të testimit;

Kalendari i organizimit të testimit dhe orari i pjesëmarrjes në testim për çdo kandidat, do të publikohen në vijim në faqen zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore www.qsha.gov.al.

Orari i pjesëmarrjes në testim do të jetë i përcaktuar dhe nuk do të mund të ketë ndryshime.

Qendra e Shërbimeve Arsimore është përgjegjëse vetëm për fazën e dytë të konkurrimit, testimin e informatizuar. Për çdo problematikë lidhur me fazat e tjera, lutemi t’i drejtoheni AKAP/DRAP përkatës.

Ju urojmë Suksese!